BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2466/2 Prot    Rrëshen më, 30 . 07 . 2024

**V E N D I M**

**Nr. 62 datë 26. 07. 2024**

**PËR**

**"MIRATIMIN DHE VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESËN E Z. GJON MARK BUNAJ, QYTETI RRËSHEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE RRËSHEN", BASHKIA MIRDITË.**

Në mbështetje të ligjit 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 45/2019, "Për mbrotjen civile", VKM nr. 329, datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkatuara nga veprimtaria njerëzore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" *i ndryshuar*, ligji nr 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ligji nr. 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024", Udhëzimit nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", në Vendimin nr. 50, datë 15.12.2023, i Këshillit bashkiak Mirditë, "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024", projekt-vendimin nga kryetari i bashkisë së bashku me dosjen e plotë të paraqitur dhe nga Komisioni i Konstatimit mbi dëmin e shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e familjes së Z. Gjon Mark Bunaj, fshati Prosek, njësia administrative Kthellë, *ku si pasojë është djegur pjesërisht kati i III-të i banesës dhe disa orendi e paisje elektroshtëpiake*, ku pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit;

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë dokumentacionin dhe preventivin e dëmit të shkaktuar nga djegia e banesës së familjes së Z. Gjon Mark BUNAJ, me një dëm total, i vlerësuar nga komisioni i konstatimit, në masën totale; **917 967.54** (nëntëqind e shatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë, pik pesëdhjetë e katër) lekë nga ku:

    a. Preventivi i vlerësimit nga ana materialeve ndërtimore: **519 067.54** (pesëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjshtëdhjetë e shtatë, pik pesëdhjetë e katër) lekë.

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al    tel dhe fax : (00355) (0) 2162233    www.bashkiamirdite.gov.al

b. Preventivi i vlerësimit të dëmeve në orendi, mobilje dhe pajisje elektro-shtëpiake, në masën: **398 900** (treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind) lekë.

2. Bashkia Mirditë nga fondet e veta akordon ndihmë financiare **50 %** të vlerës së dëmit në masën **458 983.77** (katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre, pik shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i bashkisë Mirditë, (drejtoria e zhvillimit ekonomik dhe tatim taksat).

*Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015,"Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

**SEKRETAR**

**Gaspër TOPOLLAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

**KRYETAR**

**Aleksandër PICAKU**

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2466/1 Prot. Rrëshen me, 19 . 06 . 2024

P/VENDIM

Nr 70 datë 19 / 06 / 2024

PËR

**"MIRATIMIN DHE VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESËN E Z. GJON MARK BUNAJ, FSHATI PROSEK, NJËSIA ADMINISTRATIVE KTHELLË", BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr.45/2019 "Për mbrotjen civile", VKM Nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkatuara nga veprimtaria njerëzore", ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligji nr 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" ligji nr 97/2023 "Për bugjetin e vitit 2024" "Udhëzimit Nr 9 datë 20.07.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" në VKB nr. 50 datë 15.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024" , Këshilli i Bashkisë u njoh me dosjen e plotë e paraqitur nga Komisioni mbi dëmin e shkaktuar nga rënia e zjarrit në banesën e Z. Gjon Mark Bunaj, fshati Prosek, Njësia Administrative Kthellë, ku si pasojë është djegur pjesërisht kati i tretë i banesës si dhe disa orendi e paisje elektroshtëpiake, ku pas diskutimeve të anëtarëve të këshillit,

VENDOSI:

1. Të miratojë dokumentacionin dhe preventivin e dëmit të shkaktuar nga djegia e banesës së Z.Gjon Mark Bunaj, me një dëm total, i vlerësuar nga komisioni, në masën **917.967, 54 lekë**, nga ku:

   a. Preventivi i vlerësimit nga ana materialeve ndërtimore: **519,067.54 lekë**,
   b. Preventivi i vlerësimit të dëmeve në orendi, mobilje dhe pajisje elektroshtëpiake: **398.900 lekë**.

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

2. Bashkia Mirditë nga fondet e veta akordon ndihmë financiare 50% të vlerës së dëmit në masën **458,983.77** (katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë shtatëdhjetë e shtatë) lekë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet bashkia Mirditë, (drejtoria e menaxhimit financiar dhe buxhetit).

*Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.*

| | |
|---|---|
| **SEKRETARI** | **KRYETARI** |
| **Gaspër TOPOLLAJ** | **Aleksandër PICAKU** |

***Paraqitën projektin***

| | |
|---|---|
| Administratori Nj. A Kthellë: | Astrit DEDAJ |
| Drejtori i AIKE : | Frederik VORFI |
| Drejtori Juridik: | Besian DEDAJ |

**KRYETARI**

**Albert MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

**BASHKIA MIRDITË**

Nr. 2466 Prot. Rrëshen, më 19.06.2024

**RELACION**

**PËR PROJEKT-VENDIMIN PËR "MIRATIMIN DHE VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESËN E Z. GJON MARK BUNAJ, FSHATI PROSEK, NJËSIA ADMINISTRATIVE KTHELLË"**

**Drejtuar : Këshillit të Bashkisë Mirditë**

***Të nderuar këshilltarë,***

Me datën 11.06.2024 në Fshati Prosek, në NJ.A Kthellë, në banesën e **Z. Gjon Mark Bunaj** në orën 19:00 ka rënë zjarr në banesë duke i djegur pjesërisht katin e tretë të banesës si dhe janë dëmtuar orendi dhe paisje elektroshtëpiake.

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe të VKM Nr.329 datë 16.05.2012 *"Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore, kreu 111, pika 1 gërma b"* dhe me urdhër të Kryetarit të Bashkisë me Nr. 258 datë 14.06.2024 u ngrit komisioni për verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën Z. Gjon Mark Bunaj. Është mbajtur proçes-verbali i konstatimit, evidentimi i subjektit të dëmtuar, ku në banesën e shtetasit Gjon Mark Bunaj nga rënia e zjarrit u konstatua: janë dëmtuar tavolinë ngrënie, karrige, TV, kondicioner, kolltuqe dhe rafte rrobash, krevatë etj, ka dëmtime të rrjetit elektrik, dëmtime suvatimi në dhomë, dyer të brendshme, dritare etj ku më të detajuara jepen në proçesverbalin e konstatimit, preventivin e vlerësimit të dëmeve në orendi, pajisje, elektroshtëpiake si dhe në preventivin në dëmet nga ana ndërtimore.
Preventivi i vlerësimit të dëmeve në orendi, mobilje dhe elektroshtëpiake është **398,900 lekë**.
Preventivi i vlerësimit të dëmeve nga ana materiale ndërtimore është **519,067.54 lekë.**
Vlera totale e dëmit të shkaktuar në banesë është **917,967.54 lekë**.
Pasqyrimi i djegies së banesës shoqërohet me fotografi si dhe vërtetimin për rënien e zjarrit nga Stacioni i MZSH-së Bashkia Mirditë.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin !

Konceptoi : P/Sekt E.C: Ilir GJINI

Miratoi: Drejtori AIKE: Frederik VORFI

**KRYETARI**
**Albert MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

ADRESA: SHESHI "ABAT DOÇI", RRESHEN
email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 2162233 www.bashkiamirdite.gov.al

## BASHKIA MIRDITË

Nr. 2378/2 Prot. Rrëshen, më 19.06.2024

### PROCES-VERBAL KONSTATIMI

I mbajtur sot me datë 14.06.2024 nga komisioni i ngritur me Urdhër Nr 258 .Dt. 14.06.2024 të Kryetarit të Bashkisë për verifikimin e ankesës së Z/Znj GJON MARK BUNAJ., banor i/e fshatit/qytetit PROSEK të Njësisë Administrative KTHELLË, Bashkia Mirditë.

Në zbatim të VKM nr. 329 datë 16.05.2012, "*Për kriteret dhe proçedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore*", **dhe të Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë, komisioni konstatoj këto dëme:**

**a. Nga ana ndërtimore:**

BANESË 2+1+B. JANË DËMTUAR. SUVATIMET NË TË GJITHË BANESËN, PLLAKAT NË NJË PJESË TË BANESËS, DYER TË BRENDSHME E DRITARE DURALUMINI. DËMTUAR KOMPLET SISTEMI ELEKTRIK. MË TË DETAJUARA JEPEN NË PREVENTIVIN E VLERËSIMIT TË DËMEVE NGA ANA NDERTIMORE.

**b. Në orendi, mobilje dhe paisje elektroshtëpiake:**

TAVOLINË NGRËNIE 1, KARRIKE 6, TELEVIZOR 1, MBAJTËSE TEL. 1, KOMPJUTER 1, TAPETE 2, PERDE PAL 3, KOLLTUK TEK 1, KOLLTUK DOPJO 1, KOLLTUK TRESH 1, RAFT RROBASH 3 KANATË COP 1, RAFT RROBASH 2 KANATË COP 1, KOMEDINA 2, KREVAT TEK + DYSHEK 2, BATANIE TEKE 8, ÇARÇAFË TEK 4 pal. BATANIE DOPJO 4, TAPETE 1, KONDICIONER 1, PRESIQUESE 1, MINI BAR 1. MINI BAR 1, KREVAT DOPJO DYSHEK 1

ME TË HOLLËSISHME TË DHËNAT JEPEN NË PREVENTIV

Proces-verbali mbahet në 3 (tre) kopje dhe futet në dosje për veprim të mëtejshëm.

**KOMISIONI**

1. Astrit DEDAJ
2. Ing. Genc VLADI
3. Ing. Mëhill PAÇUKU
4. Kristjan MARKU
5. Viktor VOKRRI

**KRYETARI I BASHKISË**
**Albert MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MIRDITË

## BASHKIA MIRDITË

Nr. 2378/3 Prot. Rrëshen, më 19.06.2024

### PREVENTIV
### I VLERËSIMIT TË DËMEVE NË ORENDI, MOBILJE DHE PAISJE ELEKTROSHTËPIAKE

Familjari: **Gjon Mark Bunaj**

Adresa e familjarit: **Fshati Prosek, Njësia Administrative Kthellë**

Shkaku i dëmit: **Rënie zjarri, dëmtim banese**

| Nr | Orendi,mobilje dhe paisje elektroshtëpiake | Njësisa | Sasia | Çmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Tavoline ngrenje | Copë | 1 (një) | 12.500 | 12.500 |
| 2 | Karrige | Copë | 6 (gjashtë) | 1.500 | 9.000 |
| 3 | Televizor | Copë | 1 (një) | 38.000 | 38.000 |
| 4 | Mbajtëse TV | Copë | 1 (një) | 4.500 | 4.500 |
| 5 | Kompjuter | Copë | 1 (një) | 27.000 | 27.000 |
| 6 | Tapet | Copë | 2 (dy) | 9.000 | 18.000 |
| 7 | Perde | Palë | 3 (tre) | 8.000 | 24.000 |
| 8 | Kolltuk tek | Copë | 1 (një) | 6.500 | 6.500 |
| 9 | Kolltuk tresh | Copë | 1 (një) | 21.500 | 21.500 |
| 10 | Kolltuk dopjo | Copë | 1 (një) | 11.500 | 11.500 |
| 11 | Raft rrobash 3 kanat | Copë | 1 (një) | 26.000 | 26.000 |
| 12 | Raft rrobash 2 kanat | Copë | 1 (një) | 12.000 | 12.000 |
| 13 | Komedina | Copë | 2 (dy) | 3.000 | 6.000 |
| 14 | Krevat tek + dyshek | Copë | 2 (dy) | 14.000 | 28.000 |
| 15 | Batanije teke | Copë | 8 (tetë) | 1.500 | 12.000 |
| 16 | Çarçaf tek | Palë | 4 (katër) | 1.500 | 6.000 |
| 17 | Freskuese | Copë | 1 (një) | 3.000 | 3.000 |
| 18 | Minibar | Copë | 1 (një) | 28.000 | 28.000 |
| 19 | Krevat dopjo + dyshek | Copë | 1 (një) | 34.000 | 34.000 |
| 20 | Çarçaf | Palë | 4 (një) | 1.500 | 6.000 |
| 21 | Batanie | Copë | 4 (katër) | 3.600 | 14.400 |
| 22 | Tapet | Copë | 1 (një) | 6.000 | 6.000 |
| 23 | Kondicioner | Copë | 1 (një) | 45.000 | 45.000 |
| | **SHUMA TOTALE** | | | | **398.900** |

**Shuma totale: 398.900 ( treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind ) lekë**

**Shënim: çmimet e mobiljeve, orendive janë marrë sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve**

**PREVENTIVOI**
**Kristjan MARKU**

**KOMISIONI**

Astrit DEDAJ Ing. Genc VLADI Ing. Mëhill PAÇUKU Viktor VOKRRI

**KRYETARI I BASHKISË**
**Albert MËLYSHI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE
ALBERT MELYSHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MIRDITË

# BASHKIA MIRDITË

Nr. 2378/4 Prot PREVENTIV Dt. 19.06.24

VLERESIM DEMI NGA ANA NDERTIMORE

PRONARI: GJON MARK BUNAJ, FSHATI PROSEK, NJ.A.KTHELLE.
ADRESA: FSHATI PROSEK, NJ.A.KTHELLE
OBJEKTI: BANESE 2+1+B
SHKAKU: RENIE ZJARRI, DEMTIME TE BRENDSHME

| NR.R. | NR.ANAL. | PERSHKRIMI I PUNIMEVE | NJESIA | SASIA | CMIMI | VLERA |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 1 | 2.426/11 | Prishje suvatim muri i brendshem | m2 | 81 | 344.01 | 27,864.81 |
| 2 | 2.426/12 | Prishje suvatim solete (h<4m) | m2 | 27 | 632.54 | 17,078.58 |
| 3 | 2.281 | Heqje pllaka dyshemeje | m2 | 13 | 368.43 | 4,789.59 |
| 4 | 2.37/5a | Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km | m3 | 4 | 318.6 | 1,274.40 |
| 5 | 2.31 | Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 | m2 | 81 | 1,052.85 | 85,280.85 |
| 6 | 2.3 | Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah | m2 | 27 | 1,616.96 | 43,657.92 |
| 7 | 2.383/2 | F V dyer te brendeshme druri cilesi e II-te. | m2 | 5.1 | 19,128.33 | 97,554.48 |
| 8 | 2.395/a | Dyer d/alumini me mbushje element d/a. | m2 | 4.62 | 11,427.40 | 52,794.59 |
| 9 | 2.375/2a | Dritare d/alumini dyfi xh. | m2 | 3.84 | 11,343.49 | 43,559.00 |
| 10 | 2.267/a | Shtrese me pllaka grez porcelanato | m2 | 13 | 2,530.70 | 32,899.10 |
| 11 | 2.404 | Boje hidroplastike | m2 | 169 | 238.38 | 40,286.22 |
| 12 | AnAn.2 | Dalje prize komplet | copë | 4 | 8,148.00 | 32,592.00 |
| 13 | AnAn.1 | Dalje drite komplet | copë | 4 | 9,859.00 | 39,436.00 |
| | | SHUMA Lek | | | | 519,067.54 |
| | | | | | | |

Shenim: Cmimet jane sipas manualit te miratuar me VKM.216, date 13.04.2023.
Data e hartimit te preventivit 18.06.2024.

PREVENTIVOI
Ing.Mehill PAÇUKU

KOMISIONI

Astrit Dedaj | Ing.Gena VLADI | Kristjan Marku | Viktor VOKRRI

**BASHKIA MIRDITË**

**SEKTORI MZSH**

Nr. 255 Prot

Datë.19. 06. 2024

# VËRTETIM
**Për rënie zjarri**

Vërtetojmë se me datën 11.06.2024 ora 19:00 kemi marrë njoftim nga Salla Operative Komisariati Mirditë për ngjarjen zjarrit të rënë në banesën e e shtetasit Gjon Mark Bunaj: Vendi i zjarrit: kati i tretë i banesës, në fshati Prosek, Njësia Administrative Kthellë , Bashkia: Mirditë.

Nga konstatimi ne vendin e ngjarjes deklarojme se banesa në pronësi të shtetasit Gjon Mark Bunaj është djegur pjesërisht kati i tretë i banesës me pajisje dhe orendi.

Ky vërtetim mbahet në tre kopje dhe përpilohet me kërkesën e të interesuarit me nr Prot 2378 datë 12.06.2024

**SHEFI I SEKTORIT MZSH**

**AGIM LLESHAJ**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKTORI I SHËRBIMIT TË MZSH
BASHKIA MIRDITË

Adresa; Sheshi "Abat Doçi" Rrëshen Mirditë. Tel.+355 216 22 33, e-mail:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

BANESE GJON MARK BUNAJ, FSHATI PROSEK, NJ.A. KTHELLE.

PLANIMETRIA SH 1:50




REPUBLIKA E SHQIPËRISË - SEKRETARIA - BASHKIA MIRDITË

HARTOI: Ing.Mehill PAÇUKU